



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3675 prot.

Himarë, më 12.05 2025

VENDIM

Nr. 21 . Datë 06.05 .2025

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIEN E TITULLIT “HEROIN E POPULLIT “ TRIMËRESHA ÇORRJOTE MARO DUKË KONDI.

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 14 , nenit 15 pika 1/a, nenit 16 , 19 dhe 20 të ligjit nr.112/2013”, për dekoratat , titujt e nderit , medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë “ të ndryshuar” , të VKM – së , Nr. 861, datë 10.12.2014 “ Për miratimin e rregullores të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë , si dhe materialit dhe kërkesës së paraqitur nga kryetari i fshatit Çorraj. Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e zhvilluar më datë 06.05.2025, pasi shqyrtoi kërkesën dhe propozimin e kryetarit të fshatit Çorraj , që “ Trimëresha Çorrajote Maro Kondi të shpallet Heroinë e Popullit ,

VENDOSI ;

1.Të miratojë dhënien e titullit “ Heroinë e Popullit” , për **znj. Maro Kondi** me këtë motivacion:

Me motivacionin: **Për aktin heroik dhe vetësakrificës të hedhjes nga shkëmbi së bashku me vajzën e saj në vitin 1847 , për të mos rënë në duart e pushtuesve osman , duke dëshmuar guxim të jashtëzakonshëm , përkushtim ndaj nderit dhe lirisë , si dhe për të ruajtur dinjitetin njerëzor dhe identitetin kombëtar në një nga periudhat më të errëta të historisë sonë.**

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli dhe Kryetari Bashkisë Himarë .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Dhimitër Kapaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3675/prot.

Himarë, më 12.05 2025

**RELACION: PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIEN E TITULLIT “
HEROINË E POPULLIT “ PËR TRIMËRESHËN ÇORRJOTE MARO DUKË
KONDI.**

Në mbledhjen e datës 06.05.2025 këshilli bashkiak Himarë shqyrtoi kërkesën e kryetarit të fshatit Çorraj , kërkesë e cila është protokolluar pranë Bashkisë tonë më datë 12.03.2025 , me nr.2346 prot. Ku kërkohet që Trimëresha Çorrajote Maro Kondi të shpallet “HEROINË E POPULLIT” .

Maro Kondi është gruaja e aktit trimëror të hedhjes nga shkëmbi sëbashku me vajzën e saj për të mos rënë në duart e turqve . Kjo ndodhi në vitin 1847 në malin e Harapës , në shpellën e Karanit , ku turqit kishin rrethuar fshatin u pritën me armë , duke ua bërë të pamundur të ngjiteshin në mal , por ata zunë të gjitha burimet e ujit për të detyruar banorët të dorëzoheshin , të kërcënuar nga etja , vajzat Çorrajote ja dolën të kalojnë rrethimin dhe tu çojnë bukë e ujë luftëtarëve , por turqit kapën në befasi Maro Kondin të cilës i kërkuan të tregonte shtegun e kalimit . Ajo “ pranoi” , por duke u çuar si kusht të lidheshin me litar dhe kur u fut në shtigjet e thepisura u hodh në humnerë bashkë me vajzën e saj , por edhe me ushtarët që nuk i ndaheshin , të bindur se ishte shtegu i duhur .

Kjo ngjarje heroike shprehet kryetari i fshatit Çorraj , gjendet e përjetësuar në këngët e vajet e fshatit si dhe në fshatra të tjerë të krahinës së bregdetit , një prej tyre është kënga e kënduar nga grupi i Çipinit , Vlorë, me marrës Karlo Bregun , që rezulton e krijuar dhe e kënduar në janarin e vitit 1998 në Greqi . Kënga aq brilante u ngjit edhe në skenën e koncertit të 100 – vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë , nën interpretimin e korifejve të polifonike , Paro e Goligu , me titullin aq shprehës “ Maro Kondi , hane – hane” .

As studimet rreth kësaj figure nuk kanë munguar thekson kryetari fshatit , ku thekson së pari studimin e Prof Bernard Zotaj “ gruaja e parë dëshmore” apo studimin me autor Bardhosh Hysenaj “ Maro Kondi dhe fshati Çorraj” etj. Këshilli Bashkiak Himarë në shenjë nderimi dhe kujtese për aktin sublim të trimërisë , vetëmohim dhe sakrificës për dinjitetin kombëtar dhe njerëzor vendosi ta miratojë me shumicë votash këtë kërkesë pasi ky akt

përfaqëson jo vetëm forcën e gruas shqiptare por edhe frymën e rezistencës së popullit të Labërisë dhe gjithë Shqipërisë. Me këtë vendim ne përulësisht nderojmë kujtimin e saj dhe e bëjmë një pjesë të pavdekshme të historisë sonë kombëtare.

Bashkëlidhur relacionit gjendet edhe kërkesa e kryetarit të fshatit Çorraj.

Sekretari

Elena Memushaj

